

UDHËZIM
Nr.14, datë 2.4.2008

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006 “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9856, datë 16.12.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 7.5, ndryshohet si më poshtë:

“7.5 Organizatat jofitimprurëse

Për qëllimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, organizatë jofitimprurëse është çdo shoqëri, institucion, shoqatë apo organizatë, që themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” dhe që nuk është krijuar për përfitime ose të ardhura të anëtarëve të saj dhe rregullat e së cilës nuk lejojnë shpërndarje fitimesh apo pronash për anëtarët e saj.

Në bazë të nenit 24 të ligjit, furnizimet e bëra nga organizatat jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar, që do të thotë se këto organizata duhet t’i kryejnë vetë këto furnizime dhe këto furnizime të jenë bërë kundrejt pagesës së reduktuar sipas kushteve që përcakton neni 18 i ligjit, janë furnizime të përjashtuara nëse janë furnizim shërbimesh nga organizata fetare a filozofike me qëllim mirëqenien shpirtërore.

Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar kemi në ato raste kur këto organizata nuk arkëtojnë pagesë ose pagesa që ato arkëtojnë është dukshëm më e vogël se ç’duhet të ishte nëse qëllimi i tyre do të ishte fitimi, sipas nenit 18 paragrafi 4 të ligjit mbi TVSH-në. Përkundrazi, kur këto organizata i bëjnë furnizimet e mësipërme kundrejt pagesës së plotë, ato bëjnë furnizime të tatueshme. Nëse një organizatë jofitimprurëse kryen veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër, ajo kryen veprimtari të tatueshme, pavarësisht nëse pagesa është e reduktuar apo e plotë. Në këtë rast, në qoftë se volumi i qarkullimit është më i madh se 8 milionë lekë, ajo është e detyruar të regjistrohet dhe të paguajë TVSH.”.

Në bazë të paragrafit të dytë të nenit 4 të dekretit të Presidentit, nr.1510, datë 28.6.1996 “Për disa ndryshime në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar”, mallrat e importuara kundrejt pagesës së reduktuar si ndihmë humanitare nga organizatat bamirëse humanitare, institucionet e kultit, entet publike, si dhe institucionet shtetërore buxhetore me qëllim kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit, nuk ngarkohen me TVSH.

2. Pika 7.8, ndryshohet si më poshtë:

“7.8 Barnat dhe pajisjet mjekësore

Furnizimi i barnave dhe i ambalazheve e materialeve që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, janë furnizime të përjashtuara.”.

3. Pika 7.9, paragrafit të parë “Importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat brenda vendit është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar”, i shtohet fjalia “Kjo pikë nuk zbatohet për furnizimin në import të periodikëve, revistave, shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji”.

4. Pika 7.9.3, gjatë gjithë përmbajtjes së saj, ndryshohen shprehjet si më poshtë:

“- shprehja “për një periudhë deri në gjashtë muaj” ndryshohet në “për një periudhë deri në dymbëdhjetë muaj”;

- shprehja “shtyhet deri në deri në gjashtë muaj” ndryshohet në “shtyhet deri në dymbëdhjetë muaj”;

- shprehja “mbarimi i periudhës gjashtëmujore” ndryshohet në “mbarimi i periudhës dymbëdhjetëmujore”;

- shprehja “brenda gjashtë muajve”, ndryshohet në “brenda dymbëdhjetë muajve”;

- shprehja “por jo më vonë se gjashtë muaj nga momenti i importimit” ndryshohet në “por jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga momenti i importimit”.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode